



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:017920

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05564153

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Driton Sadiku, me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, në çështjen penale ndaj të akuzuarit F.H., nga Gjakova, për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KPRK-së), si dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.34/2024, të datës 26.01.2024, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datën 11.03.2024, në prezencën e Prokurorit të shtetit Qazim Xharra, të akuzuarit F.H. dhe mbrojtësit të tij avokatin Egzon Doli nga Gjakova, i caktuar sipas detyrës zyrtare, me datën 12.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 11.04.2024 e përpilojë këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.H., nga i ati ... e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me datën ... në Gjakovë, ku edhe tani banon në rrugën "...", numër . . , i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punon si gastronom, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

Ë S H T Ë F A J T O R

I. Sepse me datën 31.12.2023, rreth orës 23:59 minuta, në rrugën "...", Komuna e Gjakovës, me dashje e në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-002 për Armët, e përdor armën në atë mënyrë që i

pandehuri natën kritike del në oborr të shtëpisë, e nxjerr dhe shtënë disa herë në ajër me armen e llojit AK/47, prodhim “Paliçan”, me numër serik 090631-89, e ku me rastin e kontrollit nga policia evidentohen tre (3) gëzhoja të predhës, si dhe nga i pandehuri sekuestrohet arma e lartcekur, dy (2) karikator të zbrazët, katër (4) fishek dhe tre (3) gëzhoja të kalibrit 7.62x39mm.

- me këto veprime ka kryer vepër penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

II. Sepse më parë e deri me datën 31.12.2023, në rrugën “...”, Komuna e Gjakovës, në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjin Nr.05/L-002 për Armët, mban në posedim armën, në atë mënyrë që pas kontrollit nga policia në shtëpinë e tij i është gjetur arma e llojit AK-47, prodhim “Palican”, me numër serik 090631-89, dy (2) karikator të zbrazët, katër (4) fishek dhe tre (3) gëzhoja të kalibrit 7.62x39mm, për çka nuk posedonte leje përkatëse, ashtu që të njëjtat sekuestrohen.

- me këto veprime ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 366 par.1 dhe 367 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPP-së të akuzuarin e:

G J Y K O N

- I. Për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, ME DËNIM ME KUSHT duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuara brenda afatit të verifikimit prej dy (2) vitesh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, si dhe;
- II. Për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej njëmijetëqind (1,800.00) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- III. Nëse i akuzuari gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale dënimi me kusht i shqiptuar mund të revokohet.
- IV. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë të akuzuarit dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga njëzet (20) euro.
- V. Ndaj të akuzuarit KONFISKOHET një (1) armë e llojit AK-47 prodhim “Palican”, me numër serik 090631-89, dy (2) karikator të zbrazët, katër (4) fishek të kalibrit 7.62x39mm dhe tre (3) gëzhoja të kalibrit 7.62x39mm, si objekte të veprave penale.
- VI. DETYROHET i akuzuari që t’i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30) euro, si dhe taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimit në shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.34/2024, të datës 26.01.2024, ndaj të akuzuarit F.H., nga Gjakova, për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 11.03.2024 në të cilën seancë kanë marrë pjesë Prokurori i shtetit Qazim Xharra, i pandehuri F.H., dhe mbrojtësi i tij av. Egzon Doli, i caktuar sipas detyrës zyrtare, në të cilin shqyrtim prokurori i shtetit ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtores dhe të dënohet sipas ligjit.

I pandehuri F.H., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, dukë shtuar se është penduar për veprimet e kryera, dhe se kjo ka qenë hera e parë që ka kryer veprën penale, gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë më asnjë veprë tjetër penale. Po ashtu ka deklaruar se nuk ka qenë i dënuar me parë për ndonjë veprë tjetër penale.

Prokurori i Shtetit i Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Qazim Xharra, duke dhënë mendim rreth pranimi të fajësisë ka deklaruar paraprakisht se duke kuptuar natyrën pasojat dhe favoret e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht po ashtu faktin se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes respektivisht në provat materiale dhe personale që përmban aktakuza në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike si në dispozitiv të kësaj aktakuze në të cilën edhe janë përmbushë elementet e veprës penale të përdorimit të armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 dhe mbajtja në pronësi kontroll posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe për faktin se aktakuza është e ligjshme dhe se provat të cilat i përmban janë të nxjerra në bazë të rregullave të përgjithshme mbi provat, në kontest të këtyre theksimeve ka shtuar se prokuroria nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit. Prokurori i shtetit po ashtu gjykatës i ka propozuar që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe të shqiptoi dënim të paraparë me ligj, duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së veprave penale. Gjykatës i ka propozuar që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë dënimit të ketë parasysh qëllimin e dënimit dhe si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë, pendimin për veprimin e kryer, premtimin se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe nuk do të bie ndesh me ligjin, ndërsa si rrethanë renduese dashjen për kryerjen e veprave penale. Gjithashtu gjykatës i ka propozuar që të bëhet konfiskimi i armës AK-47, prodhimi Palican me numër sek. 090631-89, dy karikator të zbrazët, 4 fishek të kal. 7.62x39 mm dhe 3 gëzhoja të kal. 7.62x39 mm.

Mbrojtësi i të pandehurit Egzon Doli duke dhënë mendim rreth pranimi të fajësisë ka deklaruar se pranimi i fajësisë vullnetarisht nga i mbrojturi i tij është në përputhje me faktet dhe rrethanat e çështjes të cilat janë përfshirë në aktakuzën e prokurorisë, andaj gjykatës i ka propozuar që të njëjtën ta pranoj. Tutje ka deklaruar se nga rrethanat dhe provat e çështjes del se i akuzuari është person i cili për herë të parë ka rënë ndeshë me ligjin ashtu që i njëjti në evidencë penale nuk evidentohet të ketë ndonjë rast tjetër penal ku krahas kësaj gjykatës i ka propozuar me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethanë posaçërisht lehtësuese të marrë faktin se i akuzuar e ka pranuar fajësinë në fillim të procedurës, rrethanë tjetër lehtësuese të merret se i

pandehuri sot publikisht ka kërkuar falje për veprimet e tij, duke shprehur gatishmëri që në të ardhmen të mos përsërisë vepra të njëjta apo vepra tjera penale. Gjykatës i ka propozuar që te pandehurit t'i shqiptoj dënim me gjobë përkatësisht nëse eventualisht cakton dënim me burgim të njëjtin me pëlqimin e të akuzuarit të shndërrohet në dënim me gjobë.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shteti dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari F.H., me dashje ka kryer veprën penale kryer përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si pikën I dhe II të përshkrimit faktik në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 367 par.1 të KPRK-së është parashikuar se formën themelore të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm ku parasheh se: *“Kushdo që përdorë armë apo*

*materie plasëse në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet”. Ndërsa në nenin 366 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve ku parasheh se : “ *Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet”**

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin F.H e ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilën është ngarkuar, ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, si dhe veprës mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Si rrethana lehtësuese që janë marrë për bazë me rastin e matjes së dënimit të shqiptuar ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë këto rrethana: bashkëpunimi dhe sjellja e tij tejet korrekte me gjykatën, por gjithashtu edhe me organet e ndjekjes penale, përkatësisht me policinë, ku i njëjti gjatë bastisjes së shtëpisë së tij dhe objektet përcjellëse të tij ka dorëzuar vullnetarisht armën; është hera e parë që bie ndesh me ligjin, ku në bazë të të dhënave nga evidenca penale nuk rezulton se më herët ka pasur të kaluar kriminale apo ka kryer vepër penale; gjithashtu edhe në deklaratimet e tij në shqyrtim fillestar, i njëjti ka shprehur pendimin e tij për veprën e kryer, duke deklaruar që është hera e parë që ka kryer vepër penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë ndonjë vepër penale; si dhe pranimin e fajësisë nga ana e akuzuarit në shqyrtimin fillestar për veprat penale për të cilat ngarkohet.

Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata vlerësoi rrezikshmërinë e këtyre veprave penale, ku i njëjti ka mbajtur në posedim të paautorizuar armën e llojit AK/47, prodhim “Paliçan”, e cila është një armë e llojit të rëndë, e me të cilin ka gjuajtur disa herë në ajër e që lehtë ka mundur të shkaktohet edhe ndonjë pasojë tjetër më e rëndë, e këtë duke marr parasysh edhe vendin ku ka ndodhur rasti, faktin se i njëjti ka gjuajtur në qytet ku përqendrimi i njerëzve është më i lartë, ndërsa rrethana tjera rënduese gjykata nuk ka gjetur.

Kështu që duke marr parasysh rrethanat e lartpërmendura e po ashtu gjendjen e tije ekonomike, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht dhe dënimin me gjobë të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7.Vendimi për konfiskim

Duke u bazuar në nenin 366 par.3 dhe 367 par.3 të KPRK, gjyqtari i vetëm gjykues ka vendosur që ndaj të akuzuarit F.H të konfiskohen një (1) armë e llojit AK-47 prodhim “Polician”, me numër serik 090631-89, dy (2) karikatorë të zbrazët dhe katër (4) fishekë të kalibrit 7.62x39mm dhe tre (3) gëzhoja të kalibrit 7.62x39mm, si objekt i kryerjes së veprës penale.

p8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 452 par.1 të KPP-së, ndërsa për taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 par.3 nën par.3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 364 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

2024:017920, me datën 11.04.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,
Argjelina Prenku

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Driton Sadiku

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.